



REPUBLIKA E KOSOVËS  
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO  
GJYKATA SUPREME E KOSOVËS  
VRHOVNI SUD KOSOVA – SUPREME COURT OF KOSOVO

Numri i lëndës: 2024:008840  
Datë: 20.09.2024  
Numri i dokumentit: 06187686

C-III.-12-0363

*Paditësi:*

**1.H H M**– nga Malisheva, përfaqësuar nga **av. F H** Prishtinë

**Kundër**

*E paditura:*

- 1.NSh “Mirusha” – Malishevë**, përfaqësuar nga **Agjencia Kosovare e Privatizimit**, rruga “Dritan Hoxha”, Lakrishte, nr.55 , Prishtinë,  
**2. Komuna e Malishevës** – Malishevë.

Dhoma e Posaçme e Gjykatës Supreme të Kosovës për çështjet në lidhje me Agjencinë Kosovare të Privatizimit (Dhoma e Posaçme), Kolegji i përbërë nga kryesuesja e kolegjit Hajrie Shala gjyqtare dhe anëtarët e kolegjit Gazmend Sylaj dhe Sylejman Shumolli gjyqtarë, pas seancës vendimmarrëse të mbajtur me dt.18 shtator 2024, lëshon këtë:

**A K T V E N D I M**

- Procedura në këtë çështje juridike **NDËRPRITET** për shkak të vdekjes së paditësit **H M**.
- Procedura do të vazhdohet kur trashëgimtarët e të ndjerit kërkojnë vazhdimin e procedurës.

**Rrethanat faktike dhe procedurale**

Me 18 gusht 2006, paditësit **H M** (tutje paditësi) ka dorëzuar në Dhomën e Posaçme, njoftimin se me dt.24 korrik 2006 ka parashtruar padi në Gjykatën Komunale të Malishevës kundër të paditurës **NB “Mirusha”** në Malishevë, për kthimin e patundshmërisë në posedim dhe

shfrytëzim të përhershëm. Padiësi në padi kishte propozuar që të aprohet padia e tij dhe të detyrohet e paditura t'ia kthejë në pronësi dhe shfrytëzim të përhershëm pronën kontestuese sipas fletës poseduese nr.. ZK Malishevë, e cila tani evidentohet në emër të të paditurës dhe atë ngastrën kadastrale nr.. në sipërfaqe prej 2,36.81 ha dhe ngastrën kadastrale .. në sipërfaqe prej 5,00.00 ha. Padiësi ka pohuar se këtë palujtshmëri e ka pas në pronësi, posedim dhe shfrytëzim të pandërprerë deri në marrjen me dhunë nga pushteti i atëhershëm pa kurrfarë kompenzimi.

Dhoma e Posaqme, me aktvendimin SCC-06-0379 të datës 24 tetor 2006, ka marrë vendim dhe e ka përcjellë në Gjykatën Komunale në Malishevë padinë e padiësit, pastaj në rast ankese, e njëjta të bëhet pranë Dhomës së Posaqme të Gjykatës Supreme të Kosovës, i cili vendim ishte i formës së prerë dhe detyruar për palët.

Në Gjykatën Komunale në Malishevë kjo lëndë është evidentuar dhe proceduar nën numrin C.nr. 287/06.

Gjykata Komunale në Malishevë, me aktvendimin C.nr. 287/06 të datës 02.12.2008, e ka ndërprerë procedurën në këtë çështje, ndërsa me dt.15.02.2012 kjo Gjykata ka marrë aktvendim me të cilin është shpallur inkompetente në këtë çështje juridike të padiësit dhe lënda me të gjitha shkresat i është dorëzuar në kompetencë Dhomës së Posaqme të Gjykatës Supreme.

Lënda është regjistruar pranë Kolegjit të Specializuar të Dhomës së Posaqme nën numrin C-III-12-0363, për procedim të mëtutjeshëm.

E paditura me dt. 23.10.2013 në mbrojtjen në padi ka kundërshtuar pretendimet e padiësit si të pabazuara sepse, padiësi ka parashtruar padinë në kundërshtim me nenin 6.1 të Ligjit nr.04/L-033 me të cilat dispozita parashifet se çdo kërkesë apo ankesë duhet të përcillet me prova, pastaj se nuk e ka theksuar bazën juridike në të cilën e mbështet kërkesëpadinë. Poashtu, pretendimi i padiësit se është trashëgimtar i palujtshmërisë mbi bazë të aktvendimit mbi trashëgiminë është i pabazuar, pasi që i njëjti nuk ka prezentuar aktvendimin mbi trashëgiminë në mbështetje të nenit 171 të Ligjit mbi procedurën jokontestimore (ligji nr.03/007).

Me 23 shtator 2022, gjykata ka mbajtur seancën dëgjimore në të cilën prezantoi djali i padiësit tani të ndjeri H H M- S M dhe me që i njëjti nuk kishte angazhuar përfaqësues të njëjtin e njoftoi se për të fituar cilësinë e trashëgimtarit ligjor duhet të sjellin Aktvendimin e trashëgimit të noterizuar në mënyrë që të vazhdohet procedura tutje. Për këtë nga Gjykata iu dha afati 3 muaj për kryerjen e aktit të trashëgimit.

Me dt. 11 shtator 2024, gjykata pasi që nuk morri asnjë lloj parashtrësë nga pala lidhur me shqyrtimin e trashëgimit vendosi të caktoj seancën e shqyrtimit gjyqësor.

Në seancën e mbajtur me 11 shtator 2024, prezantoi përfaqësuesi me autorizim i palës padiëse, av. F H dhe përfaqësuesi i të paditurës .

## **Arsyetimi ligjor**

Procedura në këtë çështje juridike ndërpritet për shkak të vdekjes së paditësit H H M.

Sipas nenit 76 par.3 të Ligjit Nr.06-L-086 Për Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës parasheh: *“Në interpretimin dhe zbatimin e këtij ligji, kudo që është e nevojshme për të zgjidhur një çështje procedurale që nuk trajtohet mjaftueshëm me këtë ligj, Dhoma e Posaçme do të zbatojë mutatis mutandis dispozita përkatëse të Ligjit mbi Procedurën Kontestimore.”*

Kurse, sipas dispozitës së nenit 277 pika (a) të LPK-së: *Procesi gjyqësor ndërpritet: a) kur pala ndërgjyqëse vdes ose e humbë zotësinë procedurale.*

Në vazhdim dispozita e nenit 280 par. 1 të LPK-së parasheh: *“Procedura që është ndërprerë për shkaqe të treguara në nenin 277 paragrafi 1 pika a)–d) të këtij ligji do të vazhdohet kur trashëgimtari, apo kujdestari i pasurisë trashëgimore, përfaqësuesi i ri ligjor, administratori i falimentimit apo pasardhësi juridik i personit juridik, e marrin përsipër procedurën apo kur i thërret gjykata ta bëjnë këtë.”*

Përkundër faktit se Gjykata caktoi dy seanca, duke i dhënë mundësin djalit të paditësit që të vërtetoi se është trashëgimtar ligjor i paditësit tani të ndjer, i njëjti nuk e dorëzoi vendimin e trashëgimisë për të vazhduar procedurën andaj, gjykata pas shqyrtimit ndërpreu procedurën, deri në një kërkesë për vazhdim të saj.

Andaj, duke u nisur nga gjendja e tillë e çështjes, Gjykata vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi, konform nenit 277 pika (a) dhe nenit 280 par. 1 të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK).

## **Këshillë juridike**

Kundër këtij aktvendimi mund të parashtrohet ankesë me shkrim në Kolegjin e Apelit të Dhomës së Posaçme brenda 15 ditëve nga pranimi i këtij aktvendimi. Ankesa duhet të dorëzohet në bazë të nenit 9.6 të Ligjit për Dhomën e Posaçme.

**Hajrie Shala, Gjyqtare kryesuese**

**Gazmend Sylaj, Gjyqtar**

**Sylejman Shumolli, Gjyqtar**